



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 72 Prot

Tiranë, më 21.05, 2009

VENDIM Nr. 3 dt. 20.05.2009

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, ndryshuar me ligjin nr. 9882, dt 28.02.2008, "Për Trashëgiminë Kulturore", Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 20.05.2009, pasi shqyrtoi projektet:

"Ndërhyrjet në objektet e trashëgimisë kulturore dhe historike të qytetit të Himarës, Krujës, Tiranës", të diskutuara nga Këshilli Shkencor pranë Institutit të Monumenteve të Kulturës:

VENDOSI:

I. VËREJTJE ESENCIALE

1. Mbështetur në Legjislacionin tonë të Trashëgimisë Kulturore, projektet për ndërhyrjet në objektet monument culture në Shqipëri, duhen kryer në bashkëpunim me institucionet tona të specializuara.
2. Nuk duhet përsëritur rasti që këto projekte përcillen në Institut, pranë Këshillit Shkencor dhe në KKR, pasi të kenë kaluar në shumë instance.

II. VËREJTJE TEKNIKE

A. Kalaja e Tiranës

Të miratojë në parim projektin e kalasë së Tiranës me vërejtjet përkatëse:

1. Projekt modern tepër i ngarkuar që konkuronte kalanë, për evidentimin e të cilës është edhe hartuar.
2. Të jepet në mënyrë më të saktë rrjeti inxhinjrik uji, korenti, telefoniq më tepër që po ndërtohet dhe para PD.
3. Të vendoset ura e xhamit për vizatim mbi kullë e drejtuar nga hyrja e gardës dhe të mos realizohet ura e drurit mbi këtë kullë, normal me urën e xhamit.
4. Muri i gërmuar i kalasë të ekspozohet me skarpate bari dhe kunetë për largimin e ujrave poshtë.
5. Të konsolidohet kreu i murit të kalasë.
6. Të zgjerohet rripi i gjelbëruar bri murit të kalasë.
7. Të hiqet rripi me dërrasa mbi kalldrëm.

8. Tek ura e Tabakëve, kalldrëmi që të çon nga të ndjekë aksin e urës.
9. Të ngushtohet rripit i gjelbërt rrëzë lulishtes 1 Maji, si dhe të mos realizohet shtresa me dërrasa e projektit.
10. Tek kulla katrore e hyrjes së gardës së sistemohet rrjeti telefonik dhe të dalë jashtë murit të kalasë, puseta telefonike.
11. Tek kulla e rrumbullakët të sistemohet rrjeti nëntokësor inxhinjrik:
 - a. Të hiqen dy tubat xingato sot pa funksion.
 - b. Rjeti telefonik të transportohet jashtë kullës rrethore.
 - c. Tubacioni I ujit brenda kullës të maskohet me murin në vazhdim të kalasë.
12. Në project të parashikohet vendosja e sinjalistikës për çdo object historic të murit të kalasë.
13. Punimet e mësipërme restauruese duhen ndjekur nga IMK, sipas Ligjit për Trashëgiminë Kulturore.

SHËNIM: Vërejtjet e mësipërme kanë dalë nga mbledhja e KKR dt. 20.05.2009, si dhe nga konsulta e kryer në terren më dt. 21.05.2009, me përfaqësues të MTKRS, IMK dhe palës përfaqësuese të Komunitetit European në Shqipëri.

B. Projekti i Krujës

Të miratojë në parim projektin e kalasë së Krujës me vërejtjet përkatëse:

1. Me disa ndërhyrje të vogla plotësuese të nevojshme të ruhet kalldrëmi original i Pazarit.
2. Të ruhet infrastruktura e ballit të dyqaneve.
3. Të hiqen panelet prej dërrase në kalldrëmin e Pazarit dhe të Kalasë duke ruajtur kështu kujtesën historike të rrugicave të Kalasë.
4. Në rrugicat e Kalsë të ruhet kalldrëmi original duke ndërhyrë vetëm me plotësime të nevojshme sipas teknikës ekzistuese me gurë lumi ose mali, me teknikë të çrregullt dhe jo me rrasa guri të sheshta.
5. Në shtrimin e rrugës nga Bashkia deri në Pazar, të respektohet teknika e shtrimit më rrasa guri të rregullta.
6. Në rrugën nga krojet deri në hyrjen e Kalasë, do të respektohet teknika e kalldrëmit me pllaka guri të çrregullta, të vendosura në formë mozaiku.
7. Punimet e mësipërme restauruese duhen ndjekur nga IMK, sipas Ligjit për Trashëgiminë Kulturore.


C. Projekti i Himarës

1. Ndërhyrjet në Kalanë e Himarës nuk respektojnë autenticitetin e teknikave të objekteve të ndryshme brenda Kalasë.
2. Në trajtimin e rrugëve me kalldrëm duhet ruajtur teknika ekzistuese, duke ndërhyrë vetëm me plotësime, gjithmonë mbështetur në teknikën e gjetur.
3. Nuk duhet ndjekur teknika e shtrimit të rrugicave me rrasa guri dhe trotualet e shtruara me dërrasa.

4. Adaptimi i shkallëzimeve tip kasi 2da në kalldrëm duhet realizuar mbështetur në formën dhe distancat ekzistuese.
5. Të ruhet dhe të restaurohet lëmi në pjesën e sipërme të kalasë.
6. Pranë lëmit, të mos ndërtohet teatri veror si dhe shtresën para tij, pasi në këtë pjesë të kalasë ruhen gjurmë arkeologjike.
7. Të ruhet struktura gjeologjike shkëmbore e terrenit të Kalasë.
8. Të sistemohet porta jugore e Kalasë.
9. Të konsolidohet muri jugor i Kalasë.
10. Riparimi i çatisë së Shën Serxhit dhe Bakut.
11. Punimet e mësipërme restauruese duhen ndjekur nga IMK, sipas Ligjit për Trashëgiminë Kulturore.
12. Pas rishikimit të vërejtjeve të mësipërme, projekti i Himarës do të paraqitet edhe një herë në KKR.

- Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
- Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R
ARDJAN TURKU



SEKRETAR I KKR
PROF. DR. VALTER SHTYLLA

